

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-23-0497-A0001*****Në ankesën e******Paditësi*****A Z**, fshati Sh, Viti.**kundër*****E paditura/Ankuesja***

N.SH.OP "Bentokos" (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-0060 të datës 15 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 04 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-0060 të datës 15 gusht 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 03 janar 2014, paditësi pranë DHPGJS, ka parashtruar padi për rishikimin e Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit (AL), si në vijim:

a. GJI067-0062 të datës 11 dhjetor 2013 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi), me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin për paga të pa paguara për periudhën kohore prej 01 janar 2007 deri më 15 shkurt 2007 në shumë prej 451.50 Euro.

b. GJI067-0063 të datës 11 dhjetor 2013 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi), me të cili i është refuzuar kërkesa për kompensim për tri (3) paga të pa paguara për periudhën kohore prej 15 shkurt 2007 deri më 16 maj 2007 në shumë prej 903.00 (nëntë zero tre) euro, si dhe

c. GJI067-0064 të datës 11 dhjetor 2013 (në tekstin e mëtutjeshëm vendimi) me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1.806.009 (një tetë zero gjashtë) Euro, me arsyetimin se kërkesat janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së bashkuar. Në padi paditësi ka propozuar që të aprovohen kërkesat e tij.

Paditësi në padinë e parashtruar ka theksuar se pranë NSH ka punuar nga viti 1985 e gjer më me datën 16 maj 2007 apo gjer me rastin e privatizimit të NSH. Paditësi i ka kundërshtuar Vendimet e Autoritetit të Likuidimit lidhur me parashkrimet e kërkesave kreditore. Sipas paditësit, aplikimi i dispozitës së nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar-(LPB) është në kundërshtim me rregulloren e UNMIK-ut 24/1999 dhe se ky ligj nuk do të duhej të aplikohet. Paditësi konsideron se në rastin konkret është dashur të aplikoheshin dispozitat e Rregullores 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë dhe Ligjin e Punës.

Paditësi konsideron se me njoftimin e Agjencisë të datës 16 maj 2007 i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se borxhet mbi pagat mbetin obligim i Agjencisë. Paditësi kërkesës për rishikim i ka bashkangjitur, Njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës pranë NSH, lëshuar nga Agjencia me 16 maj 2007, kopjen e librezës së punës, kopjet e vendimeve të AL, dhe kopjet e kërkesave kreditore.

Me 10 gusht 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohoi se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore. AKP-ja pohon se paditësi nuk ka ofruar argumentet e tij ligjore, me të cilën do të mbështete kërkesën për rishikim-ankesën, ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe Ligji për procedurën kontestimore - LPK. AKP përfundimisht pohon se paditësi nuk ka ofruar argumentet e tij ligjore, me të cilën do të mbështete kërkesën për rishikim-ankesën, ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së ligjit për AKP dhe Ligjit për procedurën kontestimore-LPK. AKP përfundimisht pohon se kërkesa kreditore e paditësit konsiderohet e parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Punën e Bashkuar. Ka propozuar që ankesa e paditësit të hedhet poshtë si e pa pranueshme ose refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohen vendimet e AL.

Përgjigja e AKP ju dorëzua paditësit më 10 nëntor 2021, por paditësi nuk ka parashtruar përgjigje.

Më 10 dhjetor 2021, Shkalla e I-rë kishte lëshuar urdhër për AKP, që të parashtronte listën e punëtorëve të NSH, me dëshmitë mbi pagat e tyre e të cilët ishin punëtorët e regjistruar pran NSH, deri me datën e privatizimit 16 maj 2007 si dhe nëse paditësi, A Z ishte në listën e punëtorëve të NSH dhe eventualisht paga e tij pran NSH.

Më 21 dhjetor 2021, AKP-ja me anë të një parashtrësë të parashtruar duke ju përgjigjur urdhrin të gjykatës, parashtrorë:-regjistrin e pagave të punëtorëve të NSH, për muajt janar 2007-16 maj 2007, ku nga kjo listë e bashkangjitur shihet se ankuesi, A Z, kishte pagë mujore prej 301.00 euro për muajin janar-prill gjersa

për muajin maj e që përfshin gjer më datën 16 maj paga e tij ishte 150.00 euro (nr. Rendor 6).

Me 15 gusht 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-0060, kërkesën/padinë për Rishikimin e aktvendimeve të Autoritetit të Likuidimit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar, ka Shfuqizuar vendimet e Autoritetit të Likuidimit, GJI067-0063 dhe GJI067-0064 të datë 11 dhjetor 2013, dhe ka Obliguar Autoritetin e Likuidimit të AKP që paditësit, A Z, në emër të kompensimit të tre (3) pagave të pa paguara ti paguhet shuma prej 752.00 euro si dhe në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës ti paguhet shuma prej 1.806.00 euro, e që në shumë totale përbën shumën prej 2,558.00 euro, ndërsa kërkesa ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI067-0062 të datës 11 dhjetor 2013 refuzohet si e pa bazuar dhe nuk caktohen shpenzime gjyqësore.

Në arsyetim të Aktgjykimit në lidhje me Vendimin e AL GJI067-0063 thuhet se paditësi ka arritur që të dëshmojë se ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP. Njoftimi dhe Libreza e punës të parashtruara nga paditësi si dhe regjistri i pagave të parashtruara nga AKP, argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i NSH-së gjer me datën e privatizimit, respektivisht gjer me 16 maj 2007, kohë kur edhe u privatizuar NSH-ja. Shkalla e I-rë ka theksuar në arsyetim se AKP-ja asnjëherë nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e paditësit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka paditësit do ti mohohet e drejta në kompensimin e 3 (tre) pagave. AKP faktet nuk i ka konstatuara e për më tepër provat e parashtruara siç u cekën më lartë, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt në këtë rast paditësit. Kjo shihet nga fakti se AKP edhe si një nga arsyet mbi refuzimin e kërkesës e potencon çështjen e parashkrimit. Shkalla e I-rë me rastin e aprovimit të shumës është bazuar në Regjistrin e pagave nga e cila shihet se paga mujore e paditësit, për muajin mars dhe prill ishte në shumë prej 301.00 euro, gjersa për muajin maj ishte 150.00 euro. Ketë shuma të cekur shumëzohet me tre (3) paga mujore e që i bie shuma e tërësishme prej 752.009 euro, $(301+301+150=752.00)$

euro). Andaj nga arsyet e lartcekura Shkalla e I-rë konsideron se paditësi ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.1, të shtojcës së Ligjit për AKP-në.

Sa i përket Vendimit të AL GJI067-0064 të datës 11 dhjetor 2013, Shkalla e I-rë ka konstatuar se kompensimi si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga na e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parashihet e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në. Shkalla e I-rë ka konstatua se paditësi ka ofruar dëshmi relevante që dëshmojnë se ka qenë punëtor i NSH në kohën privatizimit të tij dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP. Duke u bazuar në librezën e punës të parashtruar nga paditësi shihet se paditësi fillimisht ishte në marrëdhënie pune pranë NSH, fillimisht nga 7 tetori 1985 deri më 15 dhjetor 1985 dhe serish ka filluar më 18 prill 1986 e deri më 16 maj 2007, kur edhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Shkalla e I-rë në arsyetim ka theksuar se AKP, asnjëherë nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga na e paditësit respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka paditësit do ti mohojë e drejta në kompensimin e pagave. AKP faktet nuk i ka kontestuar e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lartë, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast paditësit. Kjo shihet nga fakti se AKP, edhe si një nga arsyet mbi refuzimin e kërkesës e potencon çështjen e parashkrimit.

Shkalla e I-rë ka kontestuar se duke u bazuar në Ligjin e punës (Ligji Nr.03/L-212), ligj ky në fuqi nga data 15 dhjetor 2010, nenit 76 paragrafi 7 pika 7.4, në kuptim të kompensimit i takojnë 6 (gjashtë) paga mujore. Në rastin konkret, bazuar në listën e pagave paga e paditësit i bie të ishte 301.00 euro sipas dispozitës së cekur si më lartë paditësit do të duhej ti takonin gjithsejtë për 6 (gjashtë) paga shuma prej 1,806.00 euro (301.00X+1,806.00). Nga të gjitha arsyet e dhëna si më lartë Shkalla e I-rë konsideron se paditësi gjithashtu ka

arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.2, të Shtojcës së Ligjit për AKP-në.

Sa i përket Vendimit AL GJI067-0062 datë 11 dhjetor 2013, në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast paditësit që në parashtresat e tij me shkrim anesën ta paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe /ose dëshmuese për mbështetjen e atij pohimi. Në këtë rast paditësi nuk ka dëshmuar ndonjë obligim ndaj tij ashtu siç parashihet sipas nenit 40 paragrafi 1.7 (kërkesat e pa siguruara, përfshirë kërkesat për paga), lidhur me nenin 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS. Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësi nuk e ka dëshmuar të drejtën e tij siç edhe parashihet sipas nenit 40 paragrafi 1.7 të Shtojcës së ligjit për AKP.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se sa i përket çështjes së parashkrimit të kërkesave të paditësit njoftimi i datës 16 maj 2007, tregon se AKP përmes organeve të saj e ka njoftuar paditësin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke filluar nga 16 maj 2007, fakt ky i pa mohueshëm që AKP , merr dhe pranon obligimet monetare ndaja paditësit dhe fakti tjetër që obligimet do të trajtojnë sipas procedurave të likuidimit, ky njoftim i drejtuar paditësit parqet fakt të mjaftueshëm andaj nga ana e gjykatës konsiderohet i pranueshëm. Shkalla e I-rë ka konstatuar paditësi ka arritur ta dëshmojë, me anë të Njoftimit ashtu siç qëndron edhe në tekstin e saj, se ka punuar pranë NSH gjer me datën 16 maj 2007 andaj pavarësisht pohimeve të AKP, paditësi e ka dëshmuar se ishte punëtor i NSH gjer më datën e fillimit të privatizimit, dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë me veprimin e Agjencisë (neni 40 i Shtojcës së Ligjit për AKP). Shkalla e I-rë në arsyetim të vendimit ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar-LPB (gazeta zyrtare e RSFJ 53/76), këtë konstatim të AKP-së , Shkalla e I-rë e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore. Shkalla e I-rë ka konstatuar

si përfundim se procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitën ligjore në fuqi, është e vetmja mënyre proceduralo-ligjore lidhur me përmbushjen e obligime kreditorë, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial.

Me 25 gusht 2022, AKP-ja e dorëzon një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-14-0060 të datës 15 gusht 2022, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet padia e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohen Vendimet e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja e kundërshton konstatimin e shkallës së I-rë sa i përket aplikimit të nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar, Autoriteti i Likuidimit thekson se ligji nr.04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përkatësisht neni 36.2.1 i Shtojcës) specifikisht parasheh parashkrimin e kërkesës si bazë për refuzim, mirëpo dispozitat në falje janë të llojit blanket (pasi nuk përcaktojnë në vetvete afatet specifike të parashkrimit dhe referojnë dispozita ligjore të aplikueshme, e që në këtë rast është neni 608 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar. AKP-ja në ankesën e parashtruar ka theksuar se neni 608 i LPB-së zbatohet sipas parashkrimeve të Rregullores së UNMIK-ut 1999/249 Neni1) e cila përcakton se ligji i zbatueshëm në Kosovë është ligji i cili ka qenë në fuqi në Kosovë më 22.03.1989 prandaj, ligjet të cilat janë miratuar nga parlamenti Jugosllav/serb pas plotësimit ligjeve që parashtruesi i referohet se kanë shfuqizuar Ligjin për punën e Bashkuar këtë qëndrim tashmë e ka konfirmuar edhe Kolegji i ankesave në aktgjykimin AC-I-14-0169-A0001 të datës 02.04.2015. Rrjedhimisht ky nen shfuqizon vetëm ato dispozitat të ligjit për Punën e Bashkuar të cilat nuk janë të pajtueshme me ligjin mbi ndërmarrjet. Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar është në pajtim të plotë me ligjin mbi Ndërmarrjet prandaj nuk është shfuqizuar dhe ka vazhduar të jetë në fuqi. Për sa më sipër, Autoriteti i Likuidimit konsideron se gjykata kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Tutje AKP-ja thekson se janë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i likuidimit është i obliguar t'i pranojë dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranojë dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afti i parë ë "Afati për Parashtrim të Kërkesave" që është afat për të dorëzuar një " dëshmi të kërkesës" në procedurën e likuidimit

(Neni 7.2.6.2 i Shtojcës së ligjit 04/L034). Ky afat thjeshtë e bën Kërkesën e paditësit të pranueshme për Autoritetin e likuidimit dhe nuk ka të bëjë me meritat e kërkesës. Paditësi ka përmbushur këtë afat dhe prandaj Autoriteti i Likuidimit ka vazhduar me ekzaminimin e meritave të kërkesave të tij. Ndërsa afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën Paditësi ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Duke qenë se parashtuesi ka parashtuar një kërkesë që i referohet pagave të pa paguara, afati i aplikueshëm (apo "afati i parashkrimit") është tre (3) vjet në përputhje me nenin 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar. Dy afatet e referuar më sipër janë të ndara dhe të dallueshme. Një kreditor i NSH-së duhet t'i përmbushë të dy afatet në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet. Nëse një kreditor dështon ta përmbushë një prej këtyre aftëve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai i ka përmbushur afatin tjetër.

AKP-ja thekson se bazuar në atë që është thënë më lartë, dy kërkesa për tre paga duhet të ishte paraqitur në Gjykatë apo në ndonjë Autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga viti 2007, kur NSH pretendohet të mos i ketë përmbushur obligimet nda parashtuesit e që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, ndërsa kërkesa për ndërprerjeje të parakohshme të marrëdhënies së punës duhet të ishte paraqitur brenda tre viteve nga momenti kur parashtuesit i ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme, pra tre vite nga 29 Qershori 2008.

Me 12 dhjetor 2023, Kolegji i Apelit ka lëshuar Urdhër për paditësin, me të cilin ankesa dhe dokumentacioni përcjellës, e parashtuar nga AKP-ja t'i dorëzohet paditësit për përgjigje, paditësi mund të parashtrojë përgjigje në ankesë brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditëve nga dita e pranimit të urdhrimit. Paditësi nuk parashtuar përgjigje ndaj ankesës së AKP-së.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me 05 nëntor 2013 ka parashtruar kërkesat tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar kompensim për 3 paga të pa paguara për periudhën 15 shkurt 2007 deri më 16 maj 2007 në shumë prej 903.00 euro nga N.SH.OP" Bentokos", kërkesën për paga të pa paguara për periudhën 01 janar 2007 deri në 15 shkurt 2007 në shumë prej 451.50 euro nga N.SH.OP" Bentokos", si dhe dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,806.00 euro (bruto) nga N.SH.OP" Bentokos", Të gjitha këto kërkesa ishin refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij i ka kundërshtuara në DHPGJS të tre vendimet e AL GJI067-0062, GJI067-0063 dhe GJI067-0064 të datës 11 dhjetor 2013 me të cilin i është refuzuar kërkesat për kompensim të pagave. Me padi paditësi ka propozuar që të aprovohen kërkesat e tij dhe kishte theksuar se aplikimi i dispozitës së nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar-(LPB) është në kundërshtim me rregulloren e UNMIK-ut 24/1999 dhe se ky ligj nuk do të duhej të aplikohet. Paditësi konsideron se në rastin konkret është dashur të aplikoheshin dispozitat e Rregullores 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë dhe Ligjin e Punës. Paditësi kishte konsideruar se me njoftimin e Agjencisë të datës 16 maj 2007 i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se borxhet mbi pagat mbesin obligim i Agjencisë.

Me 15 gusht 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-0060, kërkesën/padinë për rishikimin e vendimeve të Autoritetit të Likuidimit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar, ka Shfuqizuar vendimet e Autoritetit të Likuidimit, GJI067-0063 dhe GJI067-0064 të datë 11 dhjetor 2013, dhe ka Obliguar Autoritetin e Likuidimit të AKP që paditësit, A Z, në emër të kompensimit të tre (3) pagave të pa paguara ti paguhet shuma prej 752.00 euro si dhe në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës ti paguhet shuma prej 1.806.00 euro, e që në shumë totale përbën shumën prej 2,558.00 euro, ndërsa kërkesën ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI067-0062 të datës 11 dhjetor 2013 e ka refuzuar si të pa bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë ka bashkangjitur: Njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës pranë NSH, lëshuar nga Agjencia me 16 maj 2007, kopjen e librezës së punës, kopjet e vendimeve të AL, dhe kopjet e kërkesave kreditore. Gjatë procedurës me shkrim Shkalla e I-rë e DHPGJS, kishte siguruar nga e paditura edhe regjistrin e pagave të punëtorëve të NSH, për muajt janar 2007-16 maj 2007, ku nga kjo listë e bashkangjitur shihet se paditësi, A Z, kishte pagë mujore prej 301.00 euro për muajin janar-prill, ndërsa për muajin maj e që përfshin gjer më datën 16 maj paga e tij ishte 150.00 euro (nr. Rendor 6). Me këto dëshmi paditësi padyshim ka vërtetuar se ai kishte të drejtë që pjesërisht të i njihet e drejta në 3 paga të papaguara dhe kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës nga NSH-ja.

Kolegji i Apelit vëren se në njoftimin e dt. 16 maj 2007 të lëshur nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ishte theksuar se shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit më punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktohej kur të fillojnë këto procedura dhe paditësi me kohë kishte paraqitur kërkesat tek AL.

Siç ka konstatuar Shkalla e I-rë edhe Kolegji i Apelit vlerëson se paditësi ka ofruar dëshmi relevante që dëshmojnë se ka qenë punëtor i NSH në kohën privatizimit të tij dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa e paditësit nuk është parashkruar siç pretendon Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar. Tutje Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja në përgjigjen në ankesë nuk e ka kontestuar shprehimisht lartësinë e kërkuar të kompensimit në emër të pagave të pa paguara, andaj duke u bazuar në këtë fakt dhe në listën e pagave të siguruar nga e paditura Shkalla e I-rë me të drejtë e ka aprovuar shumën e kërkuar për kompensimin e 3 (tre) pagave. Nga Regjistri i pagave shihet se paga mujore e paditësit, për muajin mars dhe prill ishte në shumë prej 301.00 euro, gjersa për muajin maj ishte 150.00 euro ($301+301+150=752.00$ euro). Andaj me drejtë Shkalla e I-ë ka zbatuar nenin 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.1, të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, meqë paditësi ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim për tre paga të papaguara.

Shkalla e I-rë e DHPGJS gjithashtu me të drejtë e ka aprovuar shumën e kërkuar nga paditësi për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës duke u bazuar në Ligjin e punës (Ligji Nr.03/L-212). Duke u bazuar në librezën e punës të parashtruar nga paditësi shihet se paditësi fillimisht ishte në marrëdhënie pune pranë NSH, fillimisht nga 7 tetori 1985 deri më 15 dhjetor 1985 dhe serish ka filluar më 18 prill 1986 e deri më 16 maj 2007, kur edhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Përvoja e paditësit, bie në kategorinë e përcaktuar (20 gjer 29 vite shërbim). Në rastin konkret, bazuar në listën e pagave që gjendet në shkresat e lëndës paga e paditësit i bie të ishte 301.00 euro, andaj paditësit i takojnë gjithsejtë 6 gjashtë paga që përfshin shumën prej 1,806.00 euro ($301.00 \text{ euro} \times 6 \text{ paga} = 1,806.00 \text{ euro}$). Me të drejtë Shkalla e I-rë ka zbatuar nenin 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.2, të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, meqë paditësi ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet pretendimet e AKP-së e cila në ankesën e parashtruar ka theksuar se kërkesa për tre paga duhet të ishin paraqitur në Gjykatë apo në ndonjë Autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga viti 2007, kur NSH pretendohet të mos i ketë përmbushur obligimet ndaj parashtruesit e që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, ndërsa kërkesa për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës duhet të ishte paraqitur brenda tre viteve nga momenti kur parashtruesit i ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme, pra tre vite nga 29 Qershori 2008. Lidhur me këto pretendime të AKP-së Kolegji i Apelit në rastet e mbyllura në jurisprudencën e tij, shumë herë ka konstatuar se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në afatin e parashkrimit. Prandaj nuk mund të mbështetet konstatimi i gabuar i Autoritetit të Likuidimit dhe i AKP-së se kërkesa për kompensim për paga dhe ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, është parashkruar.

Andaj nga këto arsye ,ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja me 16 shtator 2022 e ka paguar taksën gjyqësore konform nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ mr.01/2017 për Unifikimin e Taksave gjyqësore të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, andaj nuk ngarkohen me taksë shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 04 prill 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues
